



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.02.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017” (*Komision për dhenie mendimi*)
3. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve, dhe marrëveshjes së saj zbatuese" (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Arben Pëllumbi, Dritan Bici dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli Lorenc Luka, Robert Bitri, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Julian Hodaj - Zëvendësministër i Brendshëm

Thimjo Plaku- Drejtor i Përgjithshëm në MEI

Alba Canaj - Përgjegjëse Sektori në MEI

Nikolin Bërzhiku – Specialist në MEI

Anisa Pina – Specialiste në MEI

Pjerina Gaxha - Drejtore e Drejtorisë së Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Meri Dedaj - Shefe në Sektorin e Legjislacionit

Aurora Alimadhi – përfaqësuese nga FSHZH-ja

Greta Gjoncaj – përfaqësuese nga FSHZH

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e komisionit! Sot në rendin e ditës kemi parashikuar 2 çështje. Çështja e parë është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017” .

Relatore e projektligjit është zonja Eglantina Gjermani. Kemi ftuar në komision përfaqësueset e FSHZH-së Aurora Alimadhi dhe Greta Gjoncaj për t’iu përgjigjur pyetjeve të anëtarëve të komisionit.

Fillojmë me një prezantim të shkurtër nga zonja Gjermani, që përveçse është relatore e komisionit, kam përshtypjen se ka qenë edhe ministria që e ka firmosur këtë marrëveshje. Më pas do të vazhdojmë me pyetjet, diskutimet dhe komentet tuaja.

Eglantina Gjermani - Faleminderit, kryetar!

Projektligji që po diskutojmë sot “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017”, vjen si nevojë e bërjes së disa ndryshimeve në tekstin e marrëveshjes së bashkëpunimit teknik për zbatimin e projektit. Unë po ju them shkurtimisht 2 ndryshimet thelbësore, që bëhen.

1. Duke qenë se, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit, ishte Ministria e Zhvillimit Urban agjencia bashkëpunëtoare e projektit, por, si pasojë e ndryshimeve në strukturën e qeverisë ky rol i jepet zëvendëskryeministrit;

2. Është bërë zgjatja e afatit të zbatimit të projektit, si nevojë e kohës për përfundimin e produkteve të tij nga 30.9.2018 deri më 31.3.2019.

E gjithë marrëveshja e firmosur nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe i gjithë fokusi i ndihmës nga qeveria zvicerane me fondet e Zyrës Austriake për Kooperim, kanë qenë kryesisht

për të ndihmuar zhvillimin rajonal në Shqipëri, për të forcuar agjencitë e zhvillimit rajonal (rritja e kapaciteteve të tyre, ngritja e institucioneve, funksionimi më i mirë i tyre dhe përmirësimi i kuadrit ligjor për zhvillimin rajonal në Shqipëri, hartimi i programeve operacionale të zhvillimit rajonal, si dhe partneriteti qeverisje qendrore- qeverisje vendore- shoqëri civile) për nxitjen në përgjithësi të programeve dhe të projekteve rajonale të zhvillimit.

Duke parë relacionin nuk mora shumë informacion. Do të kërkoja më shumë informacion nga përfaqësuesit e ministrisë dhe nga ata të FSHZH-së, i cili do të jetë realisht përgjegjës për zbatimin në praktikë të këtij projekti.

E para, unë do të kërkoja informacion lidhur me ecurinë deri tani të projektit të programit të bashkëpunimit të mbështetur nga qeveria zvicerane.

E dyta, fakti që ju sugjeroni datën 31.3.2019 më duket shumë ambicioz se është shumë afër dhe nuk besoj se do të arrini t'i realizoni dot objektivat. Mbase jam pak skeptike, por informacioni që ju do të më jepni për hapat e ndjekura, nismat që janë realizuar, fondet që janë shpenzuar, fondet dhe aktivitetet që ju kanë mbetur, mbase mund të më bindin për faktin që ju mund ta arrini limitin e afatit të propozuar për më 31.3.2019.

Desha të falënderoj qeverinë zvicerane për bashkëpunimin dhe për ndihmën në përgjithësi ndaj qeverisë shqiptare dhe në veçanti, edhe për Ministrinë e Zhvillimit Urban në atë kohë, edhe për zhvillimin rajonal në përgjithësi dhe për zhvillimin e planifikuar të territorit. Për të dyja këto çështje do të desha më shumë informacion nga të ftuarit, në mënyrë që të mund të diskutojmë më pas me kolegët e komisionit.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zonja Gjermani!

Ka pyetje për përfaqësuesit e FSHZH-së?

Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Unë kam një pyetje për propozuesit e nismës, jo vetëm për FSHZH-në.

Së pari, pse ju lindi tani nevoja për këtë ndryshim, sepse kjo është marrëveshje e muajit qershor të vitit 2017? Ndërkohë, pala që përfaqëson interesat e shtetit shqiptar, ministria e caktuar, që nga shtatori i vitit 2017 nuk është më si përkufizim. Më duket pak e çuditshme që ju lindi tani nevoja për këtë ndryshim, sikur do të bëni auditin e projektit? Praktikisht i bie që

projekti duhet të jetë pothuajse në fazën e fundit të tij. Të paktën nga ana e parave që janë ende të pashpenzuara.

Së dyti, nëse keni informacion, sa para kanë mbetur pa u shpenzuar, mundësisht sipas komponentëve?

Së treti, që e kam pak më shqetësim (është një pyetje që ka brenda edhe opinion), me sa mbaj mend kur është miratuar marrëveshja, një nga komponentët ka qenë që këto para do të përdorëshin për të ndihmuar fuqizimin e katër agjencive që ne krijuam për të mbështetur reformën dhe rajonet e mëdha. Ndërkohë, ne i shkrimë gradualisht agjencitë dhe i futëm brenda fondit.

Së katërti, nga cili institucion bëhet sot vlerësimi për efektshmërinë e përdorimit të këtij granti?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera?

Nuk e di nëse neni 2 mund të formulohet në këtë formë: “zëvendëskryeministri dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të jetë agjenci bashkëpunuese të projektit”. Nuk qëndron as nga ana gramatikore dhe as nga ana kuptimore.

Çfarë do të thotë “zëvendëskryeministri dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të jetë agjenci bashkëpunuese të projektit”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Marrëveshjen ne nuk e prekim dot. Ose e rrëzojmë ose e miratojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne e ratifikojmë atë. Nuk prekim dot nenet e dy palëve të tjera. Ne e rrëzojmë dhe jua kthejmë atyre. Ne nuk bëjmë dot amendim midis palëve. Apo jo?

Niko Peleshi – Cili është kuptimi i këtij neni? Nuk ishte propozim për ndryshim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e pranon që mund t'i ketë shpëtuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cili do të jetë roli i zëvendëskryeministrit? Agjenci bashkëpunuese nuk do të jetë, sepse do të jetë Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka pyetje të tjera.

Aurora Alimadhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, të nderuar deputetë!

Paraprakisht dua të bëj një parantezë. Do të më falni nëse nuk do të jem e aftë t'u përgjigjem të gjitha pyetjeve tuaja për shkak se jam e re në këtë institucion.

Unë jam Aurora Alimadhi, zëvendësdyrektore ekzekutive në Drejtorinë e Departamentit të Zhvillimit Rajonal në Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ishte me axhendë të parashikuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, absolutisht që nuk ka më të rëndësishëm se komisioni, por mendoj se edhe përfaqësimi nga ana ime do të jetë në nivelin e duhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ia transmetoj. Faleminderit!

Për sa i përket pyetjes së parë, të adresuar nga zonja deputete, në lidhje me ecurinë e deritanishme të projektit, bazuar në informacionet që disponojmë, është realizuar tërësisht komponenti i shpërndarjes së granteve. Njëkohësisht, subjekti zbatues i projektit ka depozituar edhe projektaktet, konkretisht, projektligji “Për zhvillimin rajonal”, si dhe disa akte nënligjore. Këto akte janë analizuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit e nga struktura të tjera, dhe u janë përcjellë disa komente, në mënyrë që të reflektohen, në mënyrë që akti të jetë sa më në përputhje me objektivat e marrëveshjes.

Për sa i përket vlerës së realizimit, unë e them me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grante për projekte rajonale, po.

Ilir Beqaj – Sa projekte kanë qenë? Jo, si lekë, por si numër, sa grante kanë qenë?

Aurora Alimadhi – Rreth njëzet grante.

Ilir Beqaj – Pak a shumë, cila është vlera mesatare e një granti?

Aurora Alimadhi – Pesëdhjetë deri në gjashtëdhjetë mijë euro.

Për sa i përket realizimeve të fondeve, sipas informacionit që ne disponojmë, janë disbursuar rreth 300 milionë lekë, dhe nga 400 milionë ngelen rreth 100 milionë për t'u disbursuar, deri në mbyllje të projektit, të fazës së tretë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro?

Në fakt, ky është informacion jo i përditësuar, pra që nuk i përket kësaj periudhe kohore, por është informacion që rezulton deri në fund të vitit 2018.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kini parasysht, ju lutem, rolin që ka Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Ne nuk jemi përgjegjës për zbatimin e projektit. Sipas marrëveshjes bazë, zbatimi i projektit bëhet nga agjencia zvicerane, e cila ka përzgjedhur një partner, që është shoqëria Ecorys, mbi bazën e një tenderi ndërkombëtar. Në këtë kuptim, zbatimi i projektit i përket kësaj shoqërie. Fondi Shqiptar i Zhvillimit përfshihet në fazën e njohjes dhe rimbursimit të TVSH-së, njëkohësisht është edhe pjesëtar i komitetit teknik, i cili bën edhe pjesën e pranimi të produkteve.

Ilir Beqaj – Si ish ministër, kam një eksperiencë të ngjashme me këtë donator. Ka një stil committee, ku palët janë të përfaqësuar, se s'mund të jetë krejt kështu. Për mendimin tim, ne kemi detyrim edhe ndaj qytetarëve tanë, por edhe ndaj taksapaguesve zviceranë. Kështu si thoni ju, ajo Ecorys, a kushdoqoftë, çdo partner që ndihmon, është kompani private, e cila vjen dhe bën punën e vet, por përgjegjësinë, në fund të fundit, qoftë me palën zvicerane, qoftë me palën tonë... E dini cili është problemi? Me sa mbaj mend, pas zgjedhjeve të fundit në Zvicër, me ndryshimet politike atje, është rritur shumë ndjeshmëria, sa i takon mënyrës se si i përdor Zvicra paratë jashtë. E gjithë rëndësia është që ky projekt të dalë jo vetëm me sa më shumë rezultate, por edhe sa më në rregull, që kur të shkosh në Zvicër, inshallah bëjnë gati një program tjetër, shumë më të madh. Vetëm në shëndetësi do të japim prapë 10 milionë, por me siguri edhe në këtë fushë, sepse e kanë me shumë ndjeshmëri. E rëndësishme është që kjo të shkojë sa më mirë në të gjitha pikëpamjet, që të kemi të drejtë të marrim një tridhjetëshe tjetër nga parlamenti

zviceran. S'është vetëm interesi i këtyre që thatë ju. Kështu që, ne s'mund të themi se e ka Ecorys. Po tashti, për shembull, fondi do të jetë? S'ka ndonjë përfaqësim qeveritar?

Aurora Alimadhi – Po, zoti deputet, ka përfaqësim qeveritar: zëvendëskryeministri është bashkëdrejtues i komitetit drejtues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk janë. Nuk ka ministri përgjegjëse.

Niko Peleshi - Nuk ka ministri përgjegjëse për zhvillimin rajonal aktualisht. Nuk e ka asnjë, sepse jam kujdesur vet për të.

Eglantina Gjermeni – A mund të na sillni informacion për realizimet e deritanishme të projektit, të paktën, me *e-mail*? Besoj se në momentin që kryhen aktivitete, hartohen ligje ose VKM, bëhet një raportim periodik te donatori për realizimet dhe ato që kanë mbetur. Kështu do të kemi një informacionin se për sa projekte janë dhënë, çfarë pakti kanë, për listën e granteve dhe çfarë ka mbetur pa u realizuar, që ta dimë se jeni të interesuar dhe 100% të bindur që do të mbarojë më 31 mars. Nëse ju keni një fije dyshimi, sugjerojmë ta shtyjmë 1 ose 2 muaj, që të mos vini sërish me procedurë të përshpejtuar për ta ndryshuar në fund të marsit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e bëjmë dot këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jeni të bindur që i realizoni e deri më 31 mars? Kam mendimin se do të vini sërish.

(Mungesë incizimi.)

Aurora Alimadhi - ... do ta përgatisim dhe do ta sjellim.

Piko Peleshi – Për seancën e komisionit.

Aurora Alimadhi - ... *(Nuk dëgjohet.)* ... informacionin dhe mundësisht brenda ditës së nesërme, pasdite, do ta përcjellim elektronikisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Niko Peleshi – Do ta kërkojmë nga Kryeministria, zëvendëskryeministri ose kabineti i tij, të na bëjë një ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër që e ka.

Kordinimin e donatorëve e ka Ministria e Financave, por historiku duhet të jetë patjetër edhe në drejtorinë e Majlinda Dukës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nga fillimi i mandatit të dytë.

Atëherë, të mos zgjatem, sepse nuk bëjmë dot ndryshime, edhe nëse ka probleme. Marrëveshja do të ratifikohet, ndaj, ju lutem, të sillni sa më shpejt materialin, që ta kemi për në seancë. Seanca do të zhvillohet ditën e martë dhe duhet ta dërgoni brenda kësaj jave elektronikisht, nëse mundeni.

Pyetje të tjera nuk ka.

Kush është dakord për miratimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017”? Kundër? Nuk ka.

Miratohet në parim.

(Diskutime pa mikrofon.)

Kemi dy nene të projektligjit për të miratuar.

Kush është dakord për miratimin e nenit 1, sipas projektligjit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka.

Miratohet!

Urdhëro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, presim pak, sa të vijë zoti Pëllumbi për të votuar nenin 2, me kuorumin e nevojshëm.

Neni 1.

Kush është dakord, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te votimi në tërësi.

Kush është dakord në tërësi për projektligjin? Kundër? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Faleminderit!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.02.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike, të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese”. (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Arben Pëllumbi, Dritan Bici dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli Lorenc Luka, Robert Bitri, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Julian Hodaj - Zëvendësministër i Brendshëm

Thimjo Plaku - Drejtor i Përgjithshëm i Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës

Alba Canaj - Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës

Nikolin Bërzhiku - Specialist në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës

Anisa Pina - Specialiste në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës

Pjerina Gaxha - Drejtore e Drejtorisë së Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Meri Dedaj – Shefe në Sektorin e Legjislacionit

Niko Peleshi – Vazhojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, për shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike, të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese”.

Relator është zoti Rakip Suli.

Ju lutem, bëni një prezantim të shpejtë! Më pas do të vazhdojmë me pyetjet për përfaqësuesit e institucioneve.

Rakip Suli – Faleminderit, kryetar!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike, të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese”.

Qëllimi i projektaktit për objekte që synohen të arrihen.

Në datën 13 shtator 2018, në Vjenë, u nënshkrua marrëveshja ndërmjet palëve të Komisionit Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike, të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese.

Palët e Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, janë: Republika e Shqipërisë, Republika e Austrisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republika e Bullgarisë, Hungarisë, Republika e Maqedonisë (tashmë Maqedonia e Veriut), Republika e Moldavisë, Mali i Zi, Rumania, Republika e Serbisë dhe Republika e Sllovenisë.

Me anë të këtij projektligji synohet financimi i bashkëpunimit policor ndërkufitar, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit, krimit ndërkufitar dhe migracionit të paligjshëm, duke luftuar kërcënimin e sigurisë publike për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale. Pra, do të krijohet mundësia për kontrole doganore...

Faleminderit!

Niko Peleshi – Këtu kemi përfaqësues të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës.

Ka ndonjë pyetje? Nuk ka pyetje.

Ka pyetje për relatorin, për ndonjë sqarim? Jo.

Kalojmë në votim.

Kush është dakord për miratimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike, të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese”?

Ka kundër? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë te miratimi nen për nen i projektligjit.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të projektligjit? Kundër? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Me miratimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike, të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese”, e mbylлим mbledhjen e ditës së sotme.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA